



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

**Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministri of Education, Science and Technology**

KURRIKULA BËRTHAMË

PËR EDUKIMIN NË FËMIJËRINË E HERSHME 0-5 VJEÇ

Mars, 2019

MINISTIRA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

Këshilli redaktues:

Kabineti i Ministrit, MASHT

Departamenti për zhvillimin e arsimit parauniversitar, MASHT

Divizioni për plane, programe dhe tekste shkollore, MASHT

Redaktor gjuhësor:

XXX

Radhitja:

XX

Ballina:

XX

Shtyp shkronja:

XX



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstvo za Obrazovanje, Nauke i
Tehnologija--Ministry of Education Science and Technology

Kabineti i Ministririt/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Numër: 470/01B
Datë: 20/09/2019

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të nenit 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta zyrtare nr. 7 / 01 mars 2019), nenit 8 paragrafi 1.4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), nxjerr:

V E N D I M

Për miratimin e Kurrikulës Bërthamë për edukimin në fëmijërinë e hershme 0-5 vjeç

1. Miratohet Kurrikula Bërthamë për edukimin në fëmijërinë e hershme 0-5 vjeç.
2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Duke u mbështetur në dispozitat e cekura më lartë dhe nevojës për miratimin e Kurrikulës Bërthamë për edukimin në fëmijërinë e hershme 0-5 vjeç, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Kabinetit të Ministririt/MASHT;
2. Zyrës së SP/MASHT;
3. DAP/MASHT;
4. Arkivit.



VENDIMI I MINISTRIT

PËRMBATJA

SHKURTESAT	7
PARATHËNIE	8
KAPITULLI I	12
STRUKTURA E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR	13
QËLLIMET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR.....	14
PARIMET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR	14
PARIMET E EDUKIMIT PARASHKOLLOR	15
ÇËSHTJET E PËRBASHKËTA TË DOKUMENTEVE TË KURRIKULAVE BËRTHAMË.....	16
KOMPETENCAT KRYESORE:	16
FUSHAT E KURRIKULËS:.....	16
KAPITULLI II	17
ZHVILLIMI I FËMIJËVE SIPAS KËNDVËSHTRIMEVE PEDAGOGJIKE DHE PSIKOLOGJIKE	17
KAPITULLI III	24
VEÇORITË E KURRIKULËS BËRTHAMË PËR GRUPMOSHËN E FËMIJËVE 0-5 VJEÇ.....	24
STRUKTURIMI I GRUPEVE EDUKATIVE 0-5 VJEÇ.....	24
ROLI I INSTITUCIONEVE PARASHKOLLORE NË ZHVILLIMIN DHE EDUKIMIN E FËMIJËVE	24
SHKALLA PËRGATITORE - EDUKIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME	24
KOMPETENCAT KRYESORE PËR EDUKIMIN NË FËMIJËRI TË HERSHME 0-5 VJEÇ	25
REZULTATET E TË NXËNIT PËR KOMPETENCA PËR EHF 0-5 VJEÇ	27
REZULTATET E TË NXËNIT PËR KOMPETENCA KRYESORE TË SHKALLËS PËRGATITORE (KRIJIMI THEMELOR I KONCEPTEVE, QËNDRIMEVE, VLERAVE), SHKALLA PËRGATITORE - EDUKIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME	27
LOJA DHE RËNDËSIA E SAJ NË ZHVILLIMIN DHE EDUKIMIN E FËMIJËVE	32
KAPITULLI IV	34
QASJET METODOLOGJIKE	34
PUNA ME FËMIJËT SIPAS METODOLOGJISË SË MONTESORIT.....	35
PUNA ME FËMIJËT SIPAS METODOLOGJISË REXHIO EMILIA	41
PUNA ME FËMIJËT SIPAS METODOLOGJISË HAP PAS HAPI.....	48
KAPITULLI V	53
PLANIFIKIMI DHE VLERËSIMI I TË ARRITURAVE TEK FËMIJËT	53
KAPITULLI VI	62
BASHKËPUNIMI ME FAMILJEN	62
KAPITULLI VII	66
ZHVILLIMI PROFESIONAL I EDUKATOREVE	66
LITERATURA	70

HARTUESIT DHE KONTRIBUESIT NË RISHIKIM:	70
LISTA E KONTAKTIT	77

SHKURTESAT

EFH	Edukimi në fëmijëri të hershme
IP	Institucione parashkollore
KB	Kurrikula Bërthamë
KKK	Korniza Kurrikulare e Kosovës
KSNA	Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
RN	Rezultatet e të Nxënit
RNK	Rezultatet e të Nxënit për Kompetenca
SHK	Shkalla e Kurrikulës
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë
PIA	Plani Individual i Arsimit

Parathënie

Edukimi në fëmijërinë e hershme është faza më e rëndësishme e zhvillimit dhe edukimit të individit pasi që pikërisht në këtë moshë fëmijët krijojnë bazën e zhvillimit të gjithanshëm të tyre. Moshë e hershme e fëmijëve është periudha në të cilën fëmijët absorbojnë çdo gjë duke e ndërtuar personalitetin e tyre dhe duke zhvilluar aspektet e tjera siç janë ato fizike, sociale, emocionale, gjuhësore dhe intelektuale.

Kësaj moshe të fëmijëve i është dhënë shumë prioritet edhe nga UNESCO duke e konsideruar si periudha e zhvillimit të hovshëm sidomos zhvillimit të trurit të fëmijëve e cila konsiderohet të jetë në kulmin e saj zhvillimor. Gjatë kësaj periudhe fëmijët ndikohen shumë nga mjedisi dhe njerëzit që e rrethojnë. Edukimi i fëmijëve në moshë të hershme është edhe një ndër qëllimet e Edukimit për zhvillim të Qëndrueshëm për edukim 2030 (UNESCO, 2019).

Prioritet në investimin e zhvillimit dhe edukimit të fëmijëve i jep edhe Bashkimi Europian, duke e bazuar atë në dokumentet kryesore për EFH sic janë: Akti mbi edukimin dhe kujdesin e fëmijëve në moshë të hershme dhe Dekretin për kujdesin ditor të fëmijëve (1973) si dhe Kurrikulën Kombëtare Qendrore për edukimin dhe kujdesin e fëmijërisë së hershme (2016) (European Commission, 2018).

Prandaj, përvojat, njohuritë, shkathtësitë, shprehjet, vlerat, botëkuptimet për vetën, shoqërinë dhe mjedisin, të fituara nga fëmijët përgjatë edukimit të hershëm të tyre, mund të vëjnë bazën për edukimit dhe zhvillimin e drejtë të tyre, përgjatë fazave të mëtejshme të rritjes dhe edukimit.

Nevoja që edukimi i hershëm i fëmijëve të jetë në agjendat shtetërore për zhvillim të qëndrueshëm dhe cilësor të tërë sistemit arsimor është paraparë në kornizën ligjore dhe në dokumentet strategjike për sistemin arsimor në vend. Duke filluar me Ligjin për edukimin parashkollor, i cili edukimin parashkollor e konsideron hallkë përbërëse të sistemit unik të edukimit dhe arsimit në Kosovë (Kuvendi i Kosoves, 2006).

Edukimi parashkollor konsiderohet i rëndësishëm edhe në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit. Ky dokument ndër pikat parësore e konsideron edukimin parashkollor. Ky

dokument vlerëson se rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucione parashkollore, do të mundësojë sukses më të madh në nivele më të larta të arsimit (RKS, 2016)

Plani strategjik i arsimit në Kosovë 2017-2021, gjithashtu e parasheh përfshirje më të madhe të fëmijëve në nivelin e edukimit parashkollor, duke e konsideruar këtë nivel si bazë të rëndësishme të sistemit parauniversitar në vend (MASHT, 2016)

Në Kornizën e Kurrikulës së Kosovës, gjithashtu, edukimi parashkollor paraqet nivelin e parë të edukimit, gjatë të cilit fëmijët zhvillohen dhe edukohen në familjet e tyre ose në institucione parashkollore. Sipas KKK edukimi i hershëm i fëmijëve i përket shkallës përgatitore, në të cilën përfshihen fëmijët nga lindja deri në 5 vjeç (MASHT, 2016).

Kurrikula bërthamë për grup-moshën 0-5 vjeç përvec se është bazuar në KKK, ajo është e ndërtuar edhe mbi Parimet e Kurrikulës Universale (2014), të Forumit Botëror (World Forum Foundation, 2014)

Ky dokument do të ndihmojë edukatorët në planifikimin, dhe organizimin e aktiviteteve edukative për fëmijët e kësaj moshe. KB 0-5 vjeç i orienton edukatorët që aktivitetet e tyre t'i fokusojnë në arritjen e rezultateve e të nxëniet për kompetencë. Arritja e RNK duhet të realizohet përmes lojës dhe aktiviteteve të tjera edukative. Synimi i këtij dokumenti është që t'iu mundësojë fëmijëve zhvillim të gjithëmbarshtëm, bazuar në fushat kurrikulare.

Megjithatë edukatorët në këtë nivel duhet t'i planifikojnë të gjitha aktivitetet e tyre përmes qasjes ndër-kurrikulare, duke e fokusuar punën e tyre në fushat e kurrikulës si tërësi. Dokumenti ka paraparë që të gjitha aktivitetet edukative të planifikohen duke bërë ndërlidhje të fushave të ndryshme, përmes së cilës i paraprijnë rezultatet e të nxëniet për aktivitet dhe këto rezultate të kontribuojnë në arritjen e rezultateve për kompetencë. Arritja e rezultateve për kompetencë do t'iu mundësojë fëmijëve që të zhvillohen në shtatë fushat kurrikulare të parapara me kornizën e kurrikulës. Duke qenë se ky dokument është përgatitur për shkallën përgatitore (mosha 0-5 vjeç), në të nuk përfshihen rezultatet për fushë siç janë në kurrikulat bërthamë për shkallë të tjera sepse këto grupmosha janë në fazën e zhvillimit të hovshëm fizik, kognitiv, social dhe emocional dhe fokusi i këtij dokumenti nuk qëndron vetëm në arritjet njohëse të fëmijës por në arritjet e çdo fushë zhvillimore. Arritjet e rezultateve për kompetencë përveç se e orienton zhvillimin e

fëmijëve në fushat zhvillimore ato drejtpërdrejtë kontribuojnë edhe në zhvillimin e fëmijëve edhe në përputhje me fushat kurrikulare.

Ky dokument ka paraparë që t'i ofroj edukatores informacione të cilat lidhen drejtpërdrejtë me zhvillimin, edukimin e fëmijës dhe faktorëve të tjerë relevant.

Kurrikula bërthamë 0-5 vjeç është i përbërë nga VII kapituj.

Në këtë dokument janë paraqitur informacione të përgjithshme të sistemit parauniversitar në Kosovë, duke e vënë theksin tek qëllimet, parimet, kompetencat dhe fushat e kurrikulës në përgjithësi por edhe ndërlidhjen e tyre me parimet e edukimit të hershëm të fëmijëve.

Gjithashtu janë ofruar informacione të përgjithshme lidhur me zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve bazuar nga këndvështrime të fushës psikologjike dhe pedagogjike. Kjo pjesë do t'iu ndihmojë edukatoreve të kuptojnë thelbin e mënyrës se si fëmija zhvillohet dhe cilat aspekte teorike e mbështesin zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve.

Në këtë dokument gjithashtu janë paraqitur specifikat e kurrikulës bërthamë për edukimin në fëmijëri të hershme 0-5 vjeç. Përveç strukturimit dhe veçorive të grupeve, kjo pjesë e paraqet edhe shkallën përgatitore, kompetencat dhe rezultatet për kompetenca. Rezultatet për kompetenca janë të ndara sipas grupmoshave 0-3 vjeç dhe 3-5 vjeç me qëllim që edukatorët të bëjnë planifikimin e aktiviteteve për arritjen e këtyre rezultateve. Ky dokument me qëllim të nxitjes së kreativitetit të edukatoreve dhe krijimit të mundësive që fëmijët të përfitojnë sa më shumë parasheh që mbi rezultatet për kompetencë, edukatorët të përcaktojnë rezultate për aktivitete duke e synuar arritjen e rezultateve për kompetencë për grup-mosha të caktuara (nga 0-5 vjeç). Qasja e punës së edukatoreve në planifikimin e aktiviteteve edukative duhet të jetë ndër-fushore, pa i specifikuar lëndët e caktuara në kuadër të fushave, për këtë arsye nuk janë të përcaktuara rezultatet për fushë, në të cilën shumë lehtë mund të zëvendësohen me lëndë mësimore. Kjo është bërë me qëllim që të eliminohen mundësitë e rrezikut që edukimi i hershëm të shkollarizohet.

KB gjithashtu u jep mundësi edukatoreve të kenë informacion të detajuar dhe praktik lidhur me qasjet metodologjike të punës me fëmijët. Janë të paraqitura metodologjitë e ndryshme dhe për secilën metodologji është e përfshirë roli i edukatores, rregullimi i mjedisit, organizimi i aktiviteteve dhe për secilën metodologji është e prezantuar nga një shembull konkret, në të cilën synon që të ndihmoj edukatoren praktikisht.

Planifikimit të aktiviteteve edukative dhe vlerësimi fëmijëve në të cilën edukatorë duhet ta bëjnë në periudha të ndryshme kohore është ndër qëllimet shumë të rëndësishme të këtij dokumenti. Me ç'rast janë prezantuar mënyra/forma në të cilën edukatorët mund t'i vlerësojnë të arriturat e fëmijëve.

Bashkëpunimi me prindërit dhe komunitetin konsiderohet si shumë i rëndësishëm. Edukimi i fëmijëve në institucionet parashkollore është i efektshëm atëherë kur bëhet përfshirja e prindërve. Ky dokument i mundëson edukatoreve që të kenë në vëmendjen e tyre prindërit, duke i parë si partner shumë të rëndësishëm në zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve.

Në bazë të parimeve të përgjithshme për hartimin e kurrikulës (World Forum Foundation, 2014), ky dokument e përmbyll ciklin e punës së edukatores duke vënë theksin në zhvillimin profesional të tyre. Me qëllim që fëmijët të ketë mundësi sa më të mira për zhvillim dhe edukim, është shumë e rëndësishme edhe fokusi i edukatoreve në ngritjen e vazhdueshme profesionale dhe vënien në shërbim tek zhvillimi dhe edukimi i fëmijëve.

Në fund janë të prezantuara edhe burimet të cilat janë shfrytëzuar për hartimin e këtij dokumenti.

KAPITULLI I

Kurrikula Bërthamë për moshën 0-5 vjeç, krahas dokumenteve tjera, e bën të zbatueshme Kornizën e Kurrikulës të Arsimit Parauniversitar¹, të miratuar nga MASHT-i, në gusht 2016. Me këtë dokument përcaktohen rezultatet për kompetenca dhe rezultatet për fusha të kurrikulës, të shprehura në njohuri shkathtësi, qëndrime dhe vlera që duhet të zhvillohen dhe arrihen nga fëmijët deri në fund të periudhave të caktuara kohore si dhe qasjen metodologjike të zbatueshmërisë, përfshirë zhvillimin, edukimin dhe vlerësimin. Gjithashtu ky dokument përcakton veprimet dhe aktivitetet për arritjen e standardeve të zhvillimit dhe edukimit në fëmijërinë e hershme 0-5 vjeç.

Dokumenti i Kurrikulës Bërthamë për grup-moshën e fëmijëve 0-5 vjeç mbështet:

- **Fëmijët** - në zhvillimin dhe edukimin gradual të tyre, në zhvillimin e personalitetit, përgatitjes së kompetencave kryesore për nxënie, në mënyrë që të krijojnë bazë të qëndrueshme për zhvillimin dhe edukimin e tyre të mëtutjeshëm;
- **Edukatoret** - në planifikimin dhe realizimin e suksesshëm të punës me fëmijët - aktivitetet në grupet edukative brenda dhe jashtë institucioneve parashkollore;
- **Prindërit** - në mbështetje, përcjelljen e saktë të nivelit të zhvillimit dhe arritjeve të kompetencave të fëmijëve të tyre në periudha të caktuara kohore, në bazë të zhvillimit të tyre fizik, emocional, social dhe njohës. që manifestohen në situata të ndryshme jetësore, në harmoni me rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare dhe kompetenca.

¹ Korniza e Kurrikulës së Kosovës është dokument i cili e rregullon tërë sistemin e arsimit parauniversitar në vend. Hallka e parë e sistemit parauniversitar fillon me edukimin në fëmijërinë e hershme (mosha 0-5 vjeç), e cila i përket shkallës 0 (sipas KSNA). Gjithsej sipas KKK janë 6 shkallë. Për secilën shkallë është paraparë kurrikula bërthamë e cila e orienton edukatoren/mësimdhënësin të planifikoj dhe organizoj procesin e edukimit/mësimdhënies duke u bazuar në rezultatet e kompetencave apo edhe rezultatet për fushë dhe aktivitet (varësisht prej shkallës). KB 0-5 vjeç është e fokusuar që të ndihmoj edukatorët të planifikojnë aktivitete edukative në mënyrë që të arrihen rezultatet për kompetencë. Arritja e rezultateve për kompetencë për secilën grup-moshë, do të kontribuojë në përgatitjen e fëmijëve për arsimim të mëtutjeshëm (në shkallët e tjera pasuese). Arritja e rezultateve të kurrikulave bërthamë ndihmon që të arrihen rezultatet të cilat janë paraparë me KKK.

Struktura e arsimit parauniversitar

Nivelet formale të arsimit parauniversitar të Kosovës përputhen me Klasifikimin Standard Ndërkombëtar të Arsimit (KSNA), përpiluar nga UNESCO. Të gjitha nivelet formale të arsimit parauniversitar janë të ndara në nën nivele formale, me emërtim - Shkallët Kryesore të Kurrikulës dhe kanë qëllime e funksione të caktuara (Shih tabelën nr. 1). Për më shumë, kurrikulat bërthamë hartohen për të gjitha nivelet formale të arsimit parauniversitar²:

Nivelet sipas KSNA		Nivelet formale të arsimit parauniversitar të Kosovës	Shkallët e kurrikulës	Kurrikulat bërthamë
		Arsimimi i të rriturve/ Arsimimi gjatë tërë jetës në shkallë të gjerë (formal dhe joformal)		
KSNA 6		Arsimi pasuniversitar		
KSNA 5		Arsimi universitar		
KSNA 4	Niveli 5 Sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve	Arsimi passekondar jouniversitar		
KSNA 3	Niveli 4 Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve	Arsimi i mesëm i lartëGjimnazet klasa X-XII Arsimit dhe aftësimi profesional/Shkollat profesionale (klasat X-XII) Matura shtetërore	Shkalla 6: Konsolidim dhe specializim- klasa XI	Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të lartë - gjimnaze
	Niveli 3 Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve	Arsimi i mesëm i lartë Arsimit dhe aftësimi profesional/ Shkollat profesionale (klasat X-XI)	Shkalla 5: Zhvillim themelor i përgjithshëm dhe profesional – klasat X, XI	Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të lartë –Arsimin dhe aftësimin profesional/ Shkollat profesionale
KSNA 2		Arsimi i mesëm i ulët Klasat VI-IX	Shkalla 4: Përforcim dhe orientim klasat VIII, IX Shkalla 3: Zhvillim i mëtejshëm dhe	Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të ulët

² Kurrikula Bërthamë për edukimin në fëmijërinë e hershme (lindje -5 vjeç); Kurrikula Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor; Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të ulët; Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të lartë-gjimnaze,dhe Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të lartë-shkolla profesionale

		orientim –klasat VI, VII	
KSNA 1	Arsim i fllor Klasat I-V	Shkalla 2: Përforcim dhe zhvillimklasat III-V	
KSNA 0	Klasa përgatitore	Shkalla 1 Përvetësim themelor - klasa përgatitore, klasat I dhe II	
	Edukimi parashkollor	Shkalla përgatitore e Kurrikulës: Edukimi në fëmijërinë e hershme	Kurrikula Bërthamë për edukimin në fëmijërinë e hershme

Tabela 1. Emërtimet e shkallëve kryesore të kurrikulës

Qëllimet e arsimit parauniversitar

Të gjitha nivelet formale të arsimit parauniversitar mbështesin nxënësit të zhvillojnë dijet, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, në harmoni me kërkesat e shoqërisë demokratike, duke:

- kultivuar identitetin personal, kombëtar, të përkatësisë shtetërore e kulturore,
- promovuar vlerat e përgjithshme kulturore dhe qytetare,
- zhvilluar përgjegjësitë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit,
- i aftësuar për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore,
- zhvilluar ndërmarrësin dhe përdorimin e teknologjisë,
- i aftësuar për mësim gjatë gjithë jetës. (MASHT, 2016)

Parimet e arsimit parauniversitar

Hartimi i kurrikulës bërthamë për grup-moshat 0-5 vjeç është bazuar në dokumentin bazë të Kornizës së Kurrikulës së Kosovës. Korniza e Kurrikulës së Kosovës gjithë zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve e mbështetë mbi parime bazë të cilat duhen të përmbushen nga të gjitha nivelet, përfshirë edhe fëmijërinë e hershme (mosha 0-5 vjeç)

Kurrikula Bërthamë siguron koherencë dhe qëndrueshmëri mes niveleve formale të arsimit parauniversitar duke u mbështetur në këto parime bazë:

Gjithëpërfshirje, që nënkupton ofrimin e mundësive për përfshirje të barabartë të të gjithë e fëmijëve dhe të rinjve në arsim cilësor;

Zhvillim të kompetencave, që reflektohet në rezultatet e të nxënit, që pritet të arrihen në mënyrë progresive dhe të vazhdueshme nga të gjithë fëmijët/nxënësit në periudha të ndryshme të edukimit dhe shkollimit;

Edukim/Mësimdhënie dhe nxënie të integruar dhe koherente, që promovon të nxënit holistik, duke reflektuar ndërlidhjen dhe ndërvarësinë e natyrës dhe të botës së krijuar nga njeriu me dijen dhe informacionin që kanë fëmijët/nxënësit për to;

Autonomi dhe fleksibilitet, në nivel institucioni parashkollor/shkollë në zbatimin e kurrikulës bërthamë dhe pjesës me zgjedhje që reflektohen në planifikim, organizim dhe realizim të procesit edukative/mësimor;

Përgjegjësi dhe llogaridhënie, që reflektohen në krijimin e kulturës për vlerësim të vazhdueshëm - ndjekje të progresit në zbatimin e kërkesave të kurrikulës përmes mbledhjes dhe analizës së të dhënave, dokumentimit të sfidave dhe zgjidhjeve, drejt një paraqitjeje më të mirë në përmbushjen e kërkesave të kurrikulës dhe ngritjes së cilësisë së arsimit (MASHT, 2016).

Parimet e edukimit parashkollor

Duke qenë se edukimi parashkollor është baza e zhvillimit të fëmijëve, përmes së cilës ndërtohet e ardhmja e tyre edhe ky nivel i ka të përcaktuara parimet e veta të cilat janë në koherencë të plotë edhe me parimet e përgjithshme të Kornizës së Kurrikulës së Kosovës. Këto parime të cilat janë të parapara me ligj, sigurojnë që të gjithë fëmijët gëzojnë të drejtën për zhvillim dhe edukim të mirëfillt. Bazuar në Ligjin mbi edukimin parashkollor, parimet të cilat duhet të respektohen janë:

- a. Barazia
- b. Gjithëpërfshirja
- c. Demokracia
- d. Autonomia e personelit
- e. Profesionalizmi dhe pergjegjësia
- f. Mundësitë e barabarta për fëmijët dhe prindërit, duke marrë parasyshë ndryshimet në mes të fëmijëve
- g. E drejta për të qenë ndryshe
- h. Zhvillimi i gjithanshëm i personalitetit të fëmijëve³

Këto parime duhet të merren parasysh dhe të respektohen nga të gjitha institucionet parashkollore, edukatorët dhe gjithë personat të cilët janë të përfshirë në punë me fëmijët e grup-moshave 0-5 vjeç, në mënyrë që fëmijëve t'ju sigurohet e drejta për zhvillim dhe edukim të mirëfilltë.

Çështjet e përbashkëta të dokumenteve të Kurrikulave Bërthamë

Kurrikulat Bërthamë të niveleve të arsimit parauniversitar, përfshirë edhe nivelin parashkollor (grup-mosha 0-5 vjeç), kanë të përbashkëta kompetencat kryesore dhe fushat kurrikulare, siç janë të përcaktuar në Kornizën Kurrikulare.

Kompetencat kryesore:	Fushat e kurrikulës:
I-Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; II-Kompetenca e të menduarit; III-Kompetenca e të mësuarit; IV-Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis; V-Kompetenca personale; VI-Kompetenca qytetare. (MASHT, 2016)	<ul style="list-style-type: none"> • Gjuhët dhe komunikimi; • Artet; • Matematika; • Shkencat e natyrës; • Shoqëria dhe mjedisi; • Edukata fizike, sportet dhe shëndeti; • Jeta dhe puna (MASHT, 2016)

Tabela 2. Kompetencat kryesore dhe fushat e kurrikulës

³ Ligji nr.02/L-52 mbi edukimin parashkollor. Shkarkuar nga <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2401>

KAPITULLI II

Zhvillimi i fëmijëve sipas këndvështrimeve pedagogjike dhe psikologjike

Programet e kujdesit dhe të edukimit në fëmijërinë e hershme, bazohen në pikëpamjet e psikologëve, pedagogëve dhe medimtarëve të tjerë, përmes së cilave shpjegohen modele të zhvillimit dhe të mësuarit të fëmijëve. Prandaj, çdo edukator i angazhuar në edukimin e hershëm në Kosovë, është me rëndësi të di dhe t'i përdorë njohuritë nga këto pikëpamje, meqë është dëshmuar të jenë të nevojshme për të realizuar dhe drejtuar një program efektiv për edukimin e hershëm (Miller, 2011).

Informacionet e prezantuara në vijim të këtij kapitulli, përshkruajnë disa nga pikëpamjet e përbashkëta të perspektivave të ndryshme teorike, duke gjithashtu ofruar hollësi dhe udhëzime për rolin e edukatorëve sipas këtyre këndvështrimeve.

Këto perspektiva teorike është vërejtur të përdoren zakonisht në dizajnimin e programeve të edukimit të hershëm në vende të ndryshme të botës. Secila nga këto perspektiva teorike ofron njohuri për çështje komplekse, informacione të cilat synohet të kontribuojnë që edukatorët të kuptojnë dhe të din ti përgjigjen rrethanave të ndryshme në kontekstin ku ato punojnë. Sidoqoftë, për shkak se shumë nga perspektivat teorike të cilat përdoren për dizajnimin e programeve të edukimit të hershëm, mund të kenë pikëpamje të ngajshme, përparësi ose kufizime, edukatorët preferohen që punën e tyre ta mbështesin në pikëpamje të ndryshme, ose të përdorin ato për të ndërtuar një çasje të integruar, dhe në harmoni me perspektiva të ndryshme. Prandaj, përgjatë dizajnit të programeve edukative, më saktësisht hartimit të aktiviteve ose realizimit të punës praktike me fëmijët, edukatorët mund të mbështeten në shumë teori për t'u informuar dhe udhëzuar se si të dizajnonë programin e punës së tyre.⁴

⁴ Shënim shtesë: Përveç informacioneve të prezantuara në këtë dokument, edukatorët e angazhuar në edukimin e hershëm pritet të kenë dhe të avancojnë në mënyrë të vazhdueshme nivelin e njohurive për veçoritë e teorive të secilit nga teoricientët dhe kontribuesit e tjerë të fushës së edukimit dhe zhvillimit në fëmijërinë e hershme në botë, meqë çdo teori mund të shërbejë me informacione shtesë për të njohur zhvillimin e fëmijëve dhe faktorët me ndikim, dhe se në thelb çdo teori egziston si e pavarur nga njëra tjetra.

Informacionet të vijim, synohet gjithashtu t'u ndihmojnë edukatorët përgjatë procesit të vendimeve që ato do të marrin, duke u ndihmuar të kuptojnë se:

- ✚ Çfarë t'u mësojnë fëmijëve, ose përmbajtjen e aktiviteteve edukative me synim stimulimin e të nxënit;
- ✚ Çasjet në raport me menaxhimin e sjelljeve tek fëmijët
- ✚ Rolin ose ndikimin e ambientit në zhvillimin dhe të nxënit tek fëmija;
- ✚ Udhëzime të veçanta për metoda ose çasje të caktura
- ✚ Se si ne [të rriturit] duhet të ndërveprojmë me fëmijët;

Perspektivat teorike ⁵		Perspektivat teorike	
Teoritë Socio-Behavioriste ⁶	Teoritë e zhvillimit ⁷	Teoritë socio-kulturale ⁸	Teoritë Kritike ⁹
Idetë kryesore	Idetë kryesore	Idetë kryesore	Idetë kryesore
<ul style="list-style-type: none"> ✚ Sjellja e papërshtatshme ose e pa pranueshme mund të zëvendësohet me sjellje të përshtatshme/të pranueshme. ✚ Ndryshimet në sjelljet e fëmijëve ndodhin për shkak të përgjigjeve/reagimeve që ata marrin ndaj sjelljeve të tyre. 	<ul style="list-style-type: none"> Zhvillimi është proces i vazhdueshëm dhe diskret; ✚ Zhvillimi është rezultat i kombinimeve gjenetike, mjedisit dhe rrethanave; ✚ Arritjet tek fëmijët ndodhin atëherë kur ai/ajo është gati për të luajtur dhe mësuar; ✚ Fëmijët mësojnë përmes eksplorimit me botën përreth tyre; ✚ Zhvillimi është holistik; 	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Zhvillimi dhe të nxënit ndodhin në ndërveprim me kontekstin ku fëmijët rriten. ✚ Krijimi i marrëdhënjëve të shëndosha me fëmijët dhe pjesëmarrja aktive e tyre në procesin e të nxënit janë thelbësore. ✚ Fëmijët zhvillohen dhe mësojnë në mënyra të shumta të cilat ndërtohen dhe miratohen 	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Fëmijët lindin me të drejta, duke përfshirë të drejtën për tu konsultuar dhe dëgjuar për çështjet që i prekin ata. ✚ Fëmijët kanë aftësinë për të marrë vendime dhe zgjedhje për të mësuarit e tyre. ✚ Transformimi shoqëror mbështetet nëpërmjet edukimit të fëmijëve për një botë më të drejtë dhe të barabartë

⁵ Adaptuar nga Nolan, A., & Raban, B. (2015) & M. E., (2006).

⁶ (Skinner, Bandura, Pavlov)

⁷ (Piaget, Donaldson, Bowlby, Montessori, Steiner, Gardner)

⁸ (Vygotsky, Malaguzzi, Rogoff, Fleer, Bruner, Brofenrenner)

⁹ (Freire, Habermas)

	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Fushat e zhvillimit: fizik, njohës emocional dhe social janë të ndërlidhura me njëra tjetrën; ✚ Zhvillimi është proces i qendrueshëm por edhe i ndryshueshëm; 	<p>nga shoqëria dhe kultura.</p> <ul style="list-style-type: none"> ✚ Fëmijët mësojnë se si të jenë të pavarur nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në ngjarje të përditshme dhe si anëtarë të grupeve të ndryshme shoqërore. ✚ Loja, të nxënit paraprijnë zhvillimin. ✚ Fëmijët janë agjentë dhe kontribues aktivë në grupe të ndryshme shoqërore, në të cilat ata marin pjesë. 	
Teoritë Socio-Behavioriste	Teorite e zhvillimit	Teoritë socio-kulturore	Teoritë Kritike
Implikimet praktike	Implikimet praktike	Implikimet praktike	Implikimet praktike
<p>Edukatorët duhet realizuar aktiviteteteve të cilat shoqërohen me shpërblime dhe përforcime;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Edukatorët përforcojnë sjelljet e duhura/të dëshiruara tek fëmijët përmes shpërbilmeve [shembull: deklaratave pozitive për sjellje të mira]; • Edukatorët shmangin përforcimin e sjelljeve të papërshtatshme; • Edukatorët zhvillojnë një gamë të gjërë të strategjive për 	<ul style="list-style-type: none"> • Edukatorët planifikojnë aktivitetete në ndërveprim me fazat e zhvillimit të fëmijëve; • Edukatorët lehtësojnë të mësuarit tek fëmijët duke planifikuar një mjedis të pasur me rutina dhe aktivitetete të bazuara në lojë, të përshtatshme për zhvillimin unik dhe holistik të fëmijëve; 	<ul style="list-style-type: none"> • Edukatorët dhe të tjerët me më shumë njohuri, mbështesin të nxënit tek fëmijët duke transformuar mësimet e reja, në plotësim të përvojave paraprake të fëmijëve. • Edukatorët duke marrë parasysh kontekstin në të cilin jetojnë fëmijët për të planifikuar aktivitetet. • Edukatorët dhe të rriturit e tjerë janë përgjegjës për të 	<ul style="list-style-type: none"> • Sipas këtyre perspektivave teorike familjet dhe fëmijët duhet të jenë pjesëmarrës me edukatorët në negociimin, zhvillimin dhe zbatimin e agjendave të mësimin, përcaktimin e rezultateve dhe të vlerësimit. • Për të mbështetur planifikimin e aktiviteteteve me synim stimulimin e të nxënit, inkurajohet përdorimi i pyetjeve kritike [shembull: Cfarë është me rëndësi për fëmijën? A është fëmija duke u dëgjuar? Si duket një ditë e mirë për fëmijën?] Për më shumë, këto dhe strategji të tjera të ngjashme përdoren për të ndihmuar fëmijët të

<p>menaxhimin e sjelljeve tek fëmijët;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Edukatorët, tërheqin vëmendjen e fëmijëve për pasojat e sjelljeve të papërshtatshme të tyre dhe i inkurajojnë të kenë sjellje të mira, duke u ofruar argumente verbale për të nxjerrë sjellje të dëshirueshme; • Edukatroët vëzhgojnë sjelljet e fëmijëve dhe i mbështesin ata vazhdimisht në përmirësimin e tyre; 	<ul style="list-style-type: none"> • Aktivitetet e planifikuara për fëmijët duhet të ndërliohen me objektivat ose qëllimet për të stimuluar të nxënëit, sipas grup moshës së fëmijëve, në mënyrë që të ndihmohen ata të zhvillohen sipas standardeve të zhvillimit. • Edukatorët vëzhgojnë fëmijët në aktivitetet e përditshme për të kuptuar dhe interpretuar zhvillimin e tyre dhe dallimet individuale. • Sipat të dhënave të mbledhura nga vëzhgimet, edukatorët planifikojnë mjediset mësimore në mënyrë që të mbështesin të nxënëit tek fëmijët; • Interpretimi i të dhënave nga vëzhgimet duhet bazuar në njohuritë per teorite e zhvillimit dhe standardeve të zhvillimit për të nxjerë konkluzione mbi të mësuarit te 	<p>mbështetur të nxënëit tek fëmijët.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Edukatorët duhet të jenë degjues aktiv dhe të respektojnë secilen të arritur tek fëmijët. • Format e shumëfishta përmes së cilave fëmijët mësojnë është me rëndësi të dokumentohen dhe të jenë të njohura për të tjerët [përshtirë prindërit]. • Edukatorët është me rëndësi që të mbajnë po ashtu shënime [raporte] përmes së cilave dokumentojnë pikat e forta dhe interesimet e fëmijëve. • Fëmijët ndërliohin përvojat dhe mësimët e fituara nga ambiente të tjera jashtë institucionit- edukativo arsimor, me përvojat e reja dhe kështu i zgjerojnë njohuritë dhe zhvillojnë aftësi të reja duke gjithashtu u dhënë kuptim përvojave të reja. 	<p>diskutojnë përgjigjet e tyre ndaj këtyre pyetjeve me edukatorët [shembull: duke luajtur role, përshkruar imazhe fotografike, diskutuar ose lozur me kukulla, etj]</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përgjatë realizimit të aktiviteteve me fëmijët, edukatorët është me rëndësi që të përfshijnë çështje mesimore përmes së cilave ngrisin nivelin e njohurive të fëmijëve për çështje të gjithëpërshtirjes, drejtësisë ose mos diskriminimit.
--	--	---	--

	fëmijët në fusha zhvillimore.		
--	-------------------------------	--	--

Perspektivat teorike		
Konstruktivistet ¹⁰	Poststrukturalistët ¹¹	Post Modernistët ¹²
Idetë kryesore	Idetë kryesore	Idetë kryesore
<ul style="list-style-type: none"> ⬇ Fëmijët ndërtojnë njohuritë e tyre në bazë të asaj që tashmë e dijnë. ⬇ Ambientet dhe paisjet ofrojnë një kuadër për ndërtimin e njohurive të fëmijët, ndërsa mësimdhënësit dhe mësimdhënësia duhet të jenë në qendër të fëmijës; ⬇ Shkathtësitë e reja tek fëmijët ndërtohet përmes praktikave në të cilët fëmija është në qendër, është aktiv, i sigurt dhe se ambienti është i përshtatshëm për zhvillimin individual të secilit fëmijë. 	<ul style="list-style-type: none"> ⬇ Identiteti i fëmijëve është kompleks dhe ndryshon përgjatë pjesëmarrjes së tyre në grupe të ndryshme sociale. ⬇ Ka shumë forma se si mund të fitohen njohuritë dhe realizohet të nxënës 	<ul style="list-style-type: none"> ⬇ Fëmijët duhet konsideruar të aftë për t'u bërë pjesë aktive e proceseve vendimarrëse, dhe duhet kuptuar se kanë aftësi të niveleve të ndryshme; ⬇ Duhet njohur shumë rrugë për të stimuluar të nxënës tek fëmijët; ⬇ Fëmijët kanë interesime të mëdha dhe të ndryshme;
Konstruktivistet	Poststrukturalistët	Post Modernistët
Implikimet praktike	Implikimet praktike	Implikimet praktike
<ul style="list-style-type: none"> • Edukatorët duhet observuar fëmijët për të vendosur aktivitetet edukative në raport me gatishmërinë dhe interesat e fëmijëve; • Edukatorët duhet të jenë në gjendje të udhëzojnë të nxënës tek fëmijët, të angazhojnë pjesëmarrjen aktive të tyre dhe të punojnë 	<ul style="list-style-type: none"> • Edukatorët është me rëndësi të përqendrohen në identifikimin e rolit që ka loja në nxitjen e bashkëveprimit në mes të fëmijëve, ndërveprimit me edukatorët, dhe nëse këto dinamika janë fer dhe të barabarta; • Fëmijët dhe të rriturit janë pjesëmarrës aktiv dhe social të cilët mbështesin përshirjen e secilit fëmijë dhe familje; 	<ul style="list-style-type: none"> • Programet edukative duhet inkurajuar dhe ose mbështetur zhvillimin social, kulturor dhe emocional të fëmijëve; • Edukatorët duhet mbështetur fëmijët të zhvillojë aftësi analitike, duke u dhënë mundësi që të mendojnë për të njejtën situatë në forma të ndryshme;

¹⁰ (Piaget, Vygotsky, Dewey); në Edwards, 2003; Mooney, 2000).

¹¹ (Foucault, MacNaughton, Canella, Grieshaber, Bourdieu)

¹² (Jenks, Qvortrup)

<p>në bashkëveprim me fëmijët, dhe jo vetëm t'u japin atyre instruksione se si duhet punuar;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Programi edukativ duhet të jetë i ndërtuar me synim që t'u ndihmoj fëmijëve të kuptojnë për botën e cila i rrethon; • Edukatorët duhet të vendosin për aktivitetet edukative në raport me aftësitë dhe njohuritë të cilat fëmijët i posedojnë, në mënyrë që të vendoset se çfarë është adekuate dhe e sigurtë për ta; • Edukatorët duhet të jenë obzervues të vazhdueshëm dhe të dokumentojnë në hollësi të gjeturat nga obzervimet, në mënyrë që të njohin dhe din të veprojnë krahas zhvillimit dhe nevojave aktuale të fëmijëve. 	<ul style="list-style-type: none"> • Përvojat mësimore ndërtohen ose ndërlihen duke u munduar të përfitohet nga njohuritë paraprake të fëmijëve; • Edukatorët përdorin strategji të shumta dhe burime nga perspektiva të ndryshme teorike për vlerësimin dhe interpretimin e të arriturave tek fëmijët. 	<ul style="list-style-type: none"> • Diversiteti i fëmijëve duhet të vlerësohet;
--	---	---